

**AKT THEMELIMI  
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI  
TË KUFIZUAR  
"Ardest" Sh.p.k.**

- Z. Ardit Stambolliu, atësia Agron, datëlindje 15.02.1996 qytetar shqiptar, mbajtës i letërnjoftimit me Nr. J60215030C, me vendlindje në Kolonjë, Lushnjë dhe banim në Kolonja 1, Shqipëri;

kam vendosur të nënshkruajë Aktin e Themelimit e mëposhtëm të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar (më poshtë "Shoqëria"), aktiviteti i së cilës rregullohet nga legjislacioni shqiptar në fuqi dhe Statuti i saj, i cili është pjesë përbërëse e këtij akti.

**Neni 1 - Emërtimi**

Emërtimi i Shoqërisë është "Ardest" Sh.p.k.

**Neni 2 - Selia**

Selia e Shoqërisë është Tiranë, Rruga Shyqyri Berxolli, Pallati Aurora, Kati i 2

**Neni 3 - Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë me një afat të pacaktuar.

**Neni 4 - Objekti i shoqërisë**

4.1 Shitje me shumicë dhe pakice online të produkteve të ndryshme.

4.2 Shoqëria ka për objekt kryerjen e aktiviteteve tregtare në përputhje me legjislacionin Shqiptar në fuqi.

- ushtrimi i drejtpërdrejtë i tregtisë në të gjitha format e saj dhe në këtë drejtim mund të lidhë kontrata në distancë, mund të mbajë, blejë, shesë, shkëmbejë hapësira reklamimi; kompania do të jetë në gjendje të blejë dhe të shkëmbejë mallra dhe shërbime që do të përdoren për shitje, import-eksport;

- shërbime marketingu, administrative, ndermjetesim, agjensie, mund të kryejë çdo lloj veprimtarie tjetër që është në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe që siguron fitime dhe të ardhura të ligjshme brenda kufijve të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, si dhe mund të kryejë çdo operacion prodhimi, tregtar dhe financiar, që lidhet drejtpërdrejtë ose terthorazi me objektin e saj, perfaqësimi dhe asistencë administrative.

**Neni 5 - Kapitali themeltar**

5.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është Lekë 10,000 (dhjetë mijë) i cili nuk është i paguar.

5.2 Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga 1 kuotë, me vlerë nominale sipas kontributit të ortakut të vetëm në kapitalin themeltar të Shoqërisë përcaktuar në nenin 6 (gjashtë) të këtij Akti.

**Neni 6 - Kontributet**

6.1 Kontributi në kapitalin e shoqërisë është si më poshtë:

- Z. Ardit Stambolliu, atësia Agron, datëlindje 15.02.1996 qytetar shqiptar, me vendlindje në Kolonjë, Lushnje dhe banim në Kolonja 1, Shqipëri; të cilit i përket një kuotë, me vlerë nominale Leke 10,000 (dhjetëmijë) që i korespondon 100% i kapitalit të Shoqërisë.

#### Neni 7 - Transferimi i kuotave

Kuotat i transferohen të tretëve sipas parashikimeve të Statutit.

#### Neni 8 - Administrimi

- 8.1 Me këtë akt emërohet 1 (një) Administratorë i Shoqërisë personi si më poshtë:
- Znj. Esmeralda Cullhaj, qytetare shqiptar, lindur më 15.05.1985, e cila emërohet për një periudhë 5 vjecare.
- 8.2 Administratori do të ushtrojë të gjitha kompetencat e administrimit të zakonshëm, në përputhje me parashikimet e nenit 95 të ligjit nr. 9901, datë 14 prill 2008 "Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare" dhe nenit 14 të Statutit.
- 8.3 Administratorit i jepen të gjitha kompetencat e nevojshme për të kryer të gjitha formalitetet dhe veprimet e parashikuara për themelimin e Shoqërisë sipas legjislacionit në fuqi. Për këtë qëllim, Administratori, mund t'u drejtohet për ndihmë të tretëve ose konsulentëve të cilëve mund të delegojnë në tërësi ose pjesërisht kryrjen e aktivitetit të sipërpërmendur.
- 8.4 Administratori është gjithashtu i autorizuar të veprojë në emër të Shoqërisë në formim e sipër deri në regjistrimin e saj pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit. Ai është gjithashtu i autorizuar, të firmosi të gjitha aktet dhe të marrë përsipër detyrime në emër të Shoqërisë që rrjedhin prej momentit të regjistrimit të saj si edhe ka të drejtë t'i delegojë kompetencat e tij personave të tjerë.

#### Neni 9- Gjuha

- 9.1 Ky Akt Themelimi është hartuar në 3 (tre) kopje në gjuhën shqipe.

#### Neni 10 - Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

- 10.1 Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin dhe/ose zbatimin e këtij statuti si edhe ato që mund të lindin në përgjithësi midis ortakëve (përveç atyre personale apo jashtë Shoqërisë) ose midis një apo më shumë ortakëve dhe Shoqërisë, do të zgjidhen në mënyrë miqësore dhe do të diskutohen në mënyrë të drejtpërdrejtë ndërmjet palëve të interesuara.
- 10.2 Në rast se nuk arrihet në një zgjidhje miqësore të mosmarrëveshjes, ato do t'i besohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

ORTAKU I VETEM  
Ardit Stambolliu



18.01.2022.